

KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot më datë 07/09/2016, bazuar në nenin 73/1/b të ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"- i ndryshuar, nenin 705 dhe vijues të ligjit nr. 7850 dt. 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" dhe statutin e shoqërisë "CC LAW OFFICE" SHPK, nënshkruhet kjo "Kontratë për shitje kuotash" si më poshtë vijon:

Neni 1

Palët kontraktuese

1. **Z. Soljan CELIBASHI**, shtetas shqiptar, banues në Tiranë, i identifikuar me kartën e identitetit nr. 024433220, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, ortak me 100% të kuotave, i shoqërisë "CC LAW OFFICE" SHPK, NIPT L11306004Q, nga këtu e më poshtë referuar si "**SHITËSI**".
dhe

2. **Z. Altin IBRO**, shtetas shqiptar, banues në Tiranë, i datëlindjes 28.03.1980, i identifikuar me kartën e identitetit nr. 024418633, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, nga këtu e më poshtë referuar si "**BLERËSI**".

Neni 2

Objekti i kontratës

Objekti i kontratës është shitja nga shitësi kundrejt blerësit, të **10 %** (dhjetë përqind) të pjesëve/kuotave ose **10** (dhjetë) kuota/pjesë të kapitalit, me një vlerë të përgjithshme prej **ALL 10.000** (dhjetë mijë lekë), që Shitësi zotëron në shoqërinë "CC LAW OFFICE" SHPK.

Neni 3

Çmimi i shitjes

Çmimi total i shitjes së kuotave që do t'i paguhet Shitësit nga Blerësi është **10.000 (dhjetë mijë) lekë**.

Neni 4

Mënyra e pagesës

Palët deklarojnë që çmimi i shitjes së kuotave i përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate, është likuiduar prej blerësit përpara nënshkrimit të kësaj kontrate.

KONTRATË SHITJE KUOTASH

1

Neni 5

Detyrimet e shitësit

Shitësi do të pranojë çmimin e shitjes, të parashikuar në Nenin 3, si çmimin e plotë dhe përfundimtar të shitjes së kuotave, që ai kishte në shoqërinë "CC LAW OFFICE" SHPK, kuota të cilat tashmë i kalojnë Blerësit.

Shitësi garanton se kuotat, të cilat shiten me këtë kontratë, nuk janë të lëna peng, në dorëzani apo të rënduara me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar i tyre e gëzon të drejta të plota mbi to.

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë nga të drejtat që ai kishte mbi kuotat objekt i kësaj kontrate.

Neni 6

Detyrimet e Blerësit

Blerësi ka paguar çmimin e blerjes, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 4 të kësaj kontrate.

Blerësi do të marrë të gjitha masat për të regjistruar transferimin e kuotave që Shitësi i kalon atij, në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 7

Gjuha e Kontratës dhe hyrja në fuqi

Kjo kontratë përgatitet në 3 kopje në gjuhën shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale.

Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës.

Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

SHITËSI

Soljan CELIBASHI

Soljan Celibashi

BLERËSI

Altin IBRO

Altin Ibro

KONTRATË SHITJE KUOTASH



2